



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 230, datë 15.11.2021

MBI

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SH.A., PËR TRANSFERIMIN E ASETETEVE TË PALUAJTSHME (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërma “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 1.3, të “Licensës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; nenit 11 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 67 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe rocedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 140/5 prot., datë 11.11.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., për transferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke) në favor të INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a.”

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ELVA 2001” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 173, datë 16.08.2021, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ELVA 2001” sh.a. për lënien peng të aseteve të paluajtshme në favor të INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a..
- Në vijim, me vendimin nr. 214, datë 15.10.2021, bordi i ERE-s vendosi:
  1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë vendimarrjen mbi kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., për transferimin e aseteve (vendosje hipoteke), në favor të INTESA SANPAOLO BANK sh.a.
  2. Brënda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e vendimit, shoqëria “ELVA 2001” sh.a. të depozitojë në ERE:
    - a) listën e transferimeve të kryera më herët, nëse ka pasur.

*b) informacion përkatës në lidhje me diferencën e konsiderueshme mes principalit të kredive dhe vlerës së aseteve të paluajtshme, mbi të cilat do të vendoset hipoteke.*

- Në zbatim të këtij vendimi, shoqëria ka depozituar në ERE deklaratën e nënshkruar nga administratori, ku deklarohet se nuk ka pasur transferime të tjera të kryera më herët.
- Për sa i përket informacionit të përcaktuar në pikën 2, gërma “b” të vendimit të bordit të ERE-s nr. 214/2021, shoqëria ka deklaruar se diferenca e vlerës së aseteve sipas pasqyrave financiare për HEC MIVAS dhe vlerës së principalit të kredive është financim me mjete të kompanisë “ELVA 2001” sh.a. Po ashtu, shoqëria shprehet se e ka informuar më herët ERE-n në lidhje me financimin e kësaj difference me fondet e vetë shoqërisë.
- Sa më sipër, konstatohet se shoqëria nuk ka kuptuar qartë kërkesat specifike të gërmës “b” të pikës të këtij vendimi, pasi në zbatim të kësaj pike nevojitet informacion mbi diferencën ndërmjet principalit të kredive dhe vlerës së aseteve për të cilat po kërkon autorizimin për t’i vendosur si mjete ganratuese të këtyre kredive, dhe jo informacion mbi vlerën fillestare të investimit dhe mënyrës së financimit të saj.
- Përveç sa më sipër, nevojitet që subjekti të saktësojë dhe qëndrimin e MIE-s, të mbajtur në shkresën nr. 2771/1 prot., datë 16.06.2021, drejtuar “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” sh.a., në lidhje me nevojën e marrjes ose jo të miratimit të MIE-s mbi këtë transferim.
- Me qëllim orientimin e drejtë të vendimmarrjes së bordit të ERE-s dhe saktësimin/qartësimin e sa më sipër, duke përfshirë dhe zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore, në zbatim të nenit 67 “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet të shtyhet me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrja e bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a. për transferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke), në favor të “INTESA SAN PAOLO BANK” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë “ELVA 2001” sh.a., për transferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke), në favor të “INTESA SAN PAOLO BANK” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.